



Rregullorja e Covid-19 mbi masat në fushën e qarkullimit ndërkombëtar të personave

Që prej datës 6 korrik 2020, ekziston detyrimi i qëndrimit në karantinë për 10 ditë, nëse keni mbërritur nga disa zona të caktuara.

Kjo masë bazohet tek Rregullorja e parandalimit të koronavirusit të ri (Covid-19) në fushën e qarkullimit ndërkombëtar të personave dhe është e vlefshme për të gjithë ata që vijnë nga shtete apo rajone me risk të shtuar të një infektimi me koronavirus.

Brenda dy ditësh nga mbërritja juaj njoftoni autoritetet përgjegjëse të kantonit tuaj dhe ndiqni udhëzimet që do t'ju japin ato. Shpenzimet e karantinës merren përsipër nga vetë personat që kanë udhëtuar.

Listën e shteteve apo rajoneve veçanërisht të rrezikuara nga infektimi me koronavirus, kontaktet e kantoneve si dhe përjashtimet nga detyrimi i karantinës i gjeni këtu:



www.bag.admin.ch/entry

Kushdo që i shmanget karantinës apo nuk respekton detyrimin për njoftim kryen një shkelje sipas ligjit të epidemive dhe mund të dënohet me gjobë monetare deri në 10 000 Franga zvicerane.

Ju lutemi të konsultoheni edhe me faqen e internetit të BAG www.bag.admin.ch/new-coronavirus për informacione të tjera, ose drejtojuni linjës së informacionit Infoline.

Linja informuese e BAG për udhëtarët: +41 58 464 44 88 (06:00 – 23:00)



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Departamenti Federal i Punëve të Brendshme EDI
Zyra Federale e Shëndetit Publik BAG